



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE**

Rr. "Agim Ramadani", Ndërtesa e Fakulteteve Teknika, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: [fim@uni-pr.edu](mailto:fim@uni-pr.edu)

Ueb: <https://fim.uni-pr.edu/>

Nr. Prot: 423  
Datë: 18/03 / 2026

Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike i Universitetit të Prishtinës, në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037, vendimit nr. prot. 2/14 datë 29.08.2025 për shfrytëzimin e hapësirave të Universitetit të Prishtinës dhe kompetencave të përcaktuara sipas nenit 56 në mbledhjen e mbajtur më 18.03.2026, miraton këtë:

**RREGULLORE PËR STANDARDIN E PARAQITJES PROFESIONALE DHE  
SIGURISË NË VESHJE NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE**

## **KAPITULLI I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë standardet minimale të veshjes dhe paraqitjes personale për studentët, stafin akademik dhe administrativ në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.
2. Synohet ruajtja e një mjedisi akademik profesional, të sigurt dhe funksional, duke respektuar parimet e standardeve të arsimit të lartë dhe traditën e institucionit.

### **Neni 2**

#### **Fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë studentët, stafin akademik, stafin administrativ dhe vizitorët gjatë qëndrimit në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.
2. Zbatimi përfshin ligjëratat, ushtrimet, provimet, punët laboratorike, projektet praktike, konferencat, prezantimet dhe aktivitetet e tjera akademike.

### **Neni 3**

#### **Parimet themelore**

1. Parimet që udhëheqin këtë rregullore përfshijnë:
  - a) profesionalizmin;
  - b) sigurinë gjatë punës dhe aktivitetit akademik;
  - c) funksionalitetin;
  - d) respektin për diversitetin dhe pa diskriminim, në përputhje me parimet e ligjit dhe standardeve evropiane.

## **KAPITULLI II – STANDARDI I VESHJES**

### **Neni 4**

#### **Kërkesat e përgjithshme**

1. Veshja duhet të jetë e pastër, e rregullt, funksionale dhe në përputhje me kërkesat e mjedisit akademik dhe teknik të fakultetit.
2. Veshja duhet të lehtësojë komunikimin normal dhe identifikimin e personit gjatë aktiviteteve akademike.

### **Neni 5**

#### **Veshjet e papranueshme**

Në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike ndalohe:

- a) veshja që mbulojnë plotësisht fytyrën dhe pamundësojnë identifikimin;
- b) veshje me mesazhe diskriminuese, fyese apo provokuese;
- c) veshje me elemente të lirshme ose të gjata që mund të paraqesin rrezik gjatë aktiviteteve laboratorike;
- d) veshje që demonstrojnë në mënyrë eksplicite dhe të pakufizuar bindje individuale dhe që pa mundëson apo e bën të papërshtatshme kryerjen normale të punës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike;

## **KAPITULLI III – VESHJA NË LABORATORË DHE PUNËTORI**

### **Neni 6**

#### **Kërkesat për siguri**

1. Gjatë ushtrimeve laboratorike dhe punëve praktike, veshja e personelit akademik dhe studentëve duhet të sigurojë lëvizje të lirë dhe të mos paraqesë rrezik për vetë personin apo për të tjerët.
2. Nuk lejohen veshje të gjata, të gjera apo materiale që mund të kapen në pajisje mekanike, kravatë.
3. Për aktivitete të caktuara laboratorike mund të kërkohet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse si përparëse laboratorike, dorëza dhe veshje mbrojtëse rezistente ndaj temperaturës dhe shkëndijave, syze, maskë ose helmetë e saldimit me filtër mbrojtës për sytë, këpucë të mbyllura dhe të përshtatshme për ambient teknik dhe mjete të tjera sigurie gjatë operimit me automjete, pajisje termike, pajisje matëse, CNC makina, Robotë industrial.
4. Personi përgjegjës për laboratorin ose ushtrimet praktike ka të drejtë të kërkojë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse dhe të ndalojë pjesëmarrjen e personave që nuk i respektojnë këto kërkesa.

## **KAPITULLI IV – AKTIVITETET ZYRTARE AKADEMIKE**

### **Neni 7**

#### **Standardet për paraqitje zyrtare**

1. Për prezantime, mbrojtje temash, konferenca dhe ceremoni zyrtare, kërkohet veshje gjysmë-formale ose formale të përshtatshme për natyrën e aktivitetit.
2. Standardet shtesë mund të përcaktohen për aktivitete specifike nga FIM.

## **KAPITULLI V – ZBATIMI DHE MASAT DISIPLINORE**

### **Neni 8**

#### **Organet përgjegjëse**

1. Zbatimi i kësaj rregulloreje mbikëqyret nga Dekani i Fakultetit dhe personeli akademik përgjegjës për procesin mësimor.
2. Personeli akademik ka të drejtë të kërkojë respektimin e standardeve gjatë zhvillimit të procesit mësimor.

### **Neni 9**

#### **Masat në rast të shkeljes**

1. Masat për shkelje të kësaj rregulloreje përfshijnë:
  - a) paralajmërim verbal;
  - b) kërkesë për rregullim të menjëhershëm të paraqitjes;
  - c) përjashtim i përkohshëm nga aktiviteti mësimor në rast të shkeljeve të përsëritura ose të rënda.
2. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me aktet e brendshme të FIM dhe statutin e Universitetit të Prishtinës.

## KAPITULLI VI – DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 10

#### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe në ditën e nënshkrimit të saj nga Dekani i FIM-UP-së.

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit

  
\_\_\_\_\_

Prof. Mirlind Bruçi, Dekan

